



VENDIM

Nr. 31 Datë 31.03.2011

MBI

**KONTRATËN PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE
NDËRMJET SHOQËRISË KESH SH.A (FURNIZUESI PUBLIK ME
SHUMICË) DHE SHOQËRISË CEZ SHPËRNDARJE SH.A
(FURNIZUESIT PUBLIK ME PAKICË) PËR PERIUDHËN 01.01.2011
DERI MË 31.12.2011**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, dhe nenit 26, pika 1, të Ligjit 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike“ i ndryshuar, pikës 4.12 dhe 4.13 gërma ”A”, pika 2, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuar me VKM nr.338, datë 19.03.2008, i ndryshuar, pikës V.1, të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 68 date 23.06.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë në mbledhjen e tij të datës 31.03.2011, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtorite Teknike të ERE, mbi kontratën “Për furnizimin me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a (Furnizuesi Publik me Shumicë) dhe shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a (Furnizuesit Publik me Pakicë) për periudhën 01.01.2011 deri më 31.12.2011“,

Konstatoi se :

Palet e kesaj kontrate KESH sh.a/FPSH dhe OSSH/FPP, jane të licensuara nga ERE përkatësisht:

- “CEZ Shpërndarje” sh.a është e licensuar për aktivitetin e Furnizuesit Publik me Pakicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr.9 datë 25.01.2008, i ndryshuar, (në atë kohë OSSH sh.a)
- “KESH” sh.a është e licensuar për aktivitetin e Furnizuesit Publik me Shumicë të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr. 11 datë 23.06.2006, i ndryshuar.

-Marrëdhënia ndërmjet KESH sh.a (FPSH) dhe CEZ Shpërndarje sh.a (FPP) është një marrëdhënie e rregulluar nga ERE.

-Është në autoritetin e ERE-s përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve respektive ndërmjet pjesëmarrësve të tregut si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërmejt tyre.

-Kërkesa e CEZ Shpërndarje sh.a që KESH sh.a të heq dorë nga garancia financiare, do të kerkonte me pare rishikim të vendimit të ERE nr.72 date 24.06.2008 “Për miratimin e kontratës tip për furnizimin me energji elektrike ndërmjet FPSH dhe FPP” pasi garancia financiare është element i përcaktuar në pikën 15 të kontratës tip të miratuar nga ERE. Garancia financiare është një element gjësisht i përdorur në praktikën tregtare. CEZ Shpërndarje sh.a me performancën e saj të deritanishme në marrëdhëniet me KESH sh.a nuk ka demonstruar korrektesë në shlyerjen e pagesave ndaj FPSH –së e cila të mund të justifikonte kërkesën për heqjen e garancisë financiare nga kontrata. CEZ Shpërndarje sh.a e kushtëzoi vendosjen e Garancisë Financiare me vendosjen e Garancisë së performancës vendosja e së cilës është pranuar nga KESH sh.a me shkresën nr.7691/8 prot, date 15.02.2011.

-Sasia e energjisë elektrike për tu lejuar për efekt të zbatimit të kësaj kontrate është sasia 4.235 GWh, e përlogaritur në përputhje me planifikimin për efekt të llogaritjes së tarifës së furnizimit publik me shumicë miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.97, date 07.12.2010.

-Kryerja e Pagesës për levrimitin e energjisë elektrike sipas opsionit a) të parashikuar në modelin e kontratës tip të miratuar nga ERE (në ditën e 30-të, të muajit kalendarik dhe nëse nuk përkon me Ditë Punë menjëherë në ditën më pas) është në një linjë me mbledhjen e pagesave nga CEZ Shpërndarje në kontratat e saj të furnizimit me konsumatorët tariforë të energjisë elektrike.

-Lidhur me problemin e devijimeve balancimit vërehet se nuk është e njëjta gjë me sasitë për planifikim të energjisë elektrike. Në kuptim të Rregullave të Tregut, pika VII, balancimet trajtohen siç është kapitulli VII, Rregullat për tregun balancues dhe kanë të bëjnë me devijimet orare. Nga ana tjetër disbalancat duhet të trajtohen në një kohë të dytë, praktike kjo e pranuar nga ERE edhe në procesin e miratimit të kontratës së shërbimit ndërmjet OST sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a, pasi ato janë objekt i rregullimit të një rregulloreje të veçantë dhe jo i kësaj kontrate.

-Në lidhje me Skedulën e levrimitit (Nominimi fizik i programit) në përputhje me pikën VI, 3.4 të Rregullave të Tregut, Nominimi fizik për ditën e nesërme duhet paraqitur në orën 13:00. Si të tillë konstatojmë të drejtë qëndrimin e CEZ Shpërndarje sh.a.

Për sa më sipër evidentuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e kontratës për furnizim me energji elektrike ndërmjet shoqërisë KESH sh.a (Furnizuesi Publik me Shumicë) dhe shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a (Furnizuesi Publik me Pakicë) për periudhën 01.01.2011 – 31.12.2011 sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin e efektet nga data 1 Janar 2011 deri më datë 31 Dhjetor 2011.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.